VENDIM
Nr.1294, datë 27.9.2008

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 13.11.2007 PËR ÇËSHTJEN "RAMADHI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 "Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", dhe të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të datës 13.11.2007 për çështjen nr.38222/02, "Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë", në shumën 65 676 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) euro.
2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 29 shtator 2008.
3. Shuma 65 676 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) euro të depozitohet në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve "Ramadhi dhe të tjerë", dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së llogarisë.
4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, ndaj ankuesve "Ramadhi dhe të tjerë", të bëhet nga Ministria e Financave, nga fondi i shpronësimeve, në llogarinë speciale pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm, për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.
5. Detyrimi financiar i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha